



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 40

Datë: 07. 10. 2020. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesues i mbledhjes: Artan Asllani, anëtarë i kryesisë.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burmi ahmeti, kryeshef i KQZ-së.

Përkthyese: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### RENDI I DITËS

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**  
-Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 35, 36 dhe 37/2020

**2. Aktivitetet e ZRPP-së:**

- Njoftim për aplikimin e një iniciative për regjistrim të partisë politike

**3. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

**a. Këshilli për Çështje Ligjore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Gjakovë,
- Njoftim lidhur me publikim të raporteve vjetore financiare të subjekteve politike,

**b. Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Njoftim lidhur me reportin “Analizë e të dhënave nga Departamenti i Pensioneve në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale”

-Shqyrtimi dhe miratimi i aplikacionit për votim jashtë Kosovës

#### 4.Të ndryshme

---

##### **1.Hyrje: znj. Arianit Asllani: Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 35, 36 dhe 37/2020

**Artan Asllani:** Po e hapi mbledhjen e 40-të të KQZ-së, kemi kuorum. Jemi 11 anëtarë. E keni pasur rendin e ditës...A pajtoheni me këtë rend dite ?

**Alim Rama:** Ua kam dërguar një imell të hënën për një pikë shtesë të rendit të ditës. Kjo është për disa herë. Pra, kërkesa ime ka të bëj me zgjedhjet në Podujevë. Z.Rama, e arsyetoi kërkesën e tij në realizimin e procesit zgjedhor, madje duke u bazuar edhe në shembuj konkret pavarësisht nga masat e pandemisë, si dhe kërkoi që Sekretariati të përgatisë një informatë ose raport lidhur me përgatitjen, realizimin (vazhdimin) e mbajtjes së zgjedhjeve në Podujevë që, siç e dimë për arsyen e shfaqjes së pandemisë, ishin ndëprerë...!

**Burim Ahmeti:** Propozoj që në pikën e dytë, të shtohen aktivitetet e Sekretariatit !

**Arianit Elshani:** Është fakt që nuk është hera e parë që është ngritur kjo çështje, e vlerësoj mendimin e z. Alimi, por rrëthanat kanë ndikuar që këto zgjedhje të shtyhen. Kështu, vlerësoj se gatishmëria jonë është e vazhdueshme, por kjo nuk varet nga ne dhe varet nga rrëthanat e ndryshme, edhe prej pandemisë. Ky proces nuk është pa rreziqe, pra të respektohen kompetencat dhe përgjegjësitë e KQZ. Nuk është në kompetencën tonë, prandaj të them që kjo është kompetencë e Presidentit. Ne, jemi të gatshëm dhe duhet t'i kemi parasysh rrëthanat. Pra, nuk e mbështesë këtë propozim...

**Sami Kurteshi:** Realisht, ka disa muaj, pra, edhe shtyrja e zgjedhjeve ka qenë – shtyrja – antikushtetuese. Kërkesa filloj për gjendjen, nga ISHKP-ja ka shkuar te KQZ-ja. Nga kryesuesja, në mënyrë autonome pa u pyetur KQZ...Zgjedhjet janë shtyrë pa afat të caktuar. Dhe nuk ka kështu, kjo është e tepërt...Ka tre – katër muaj që ne kërkojmë të mbahen zgjedhjet në Podujevë dhe në Mitrovicën e veriut. Nga ajo që dëgjuam nga z. Rama, nuk ka asnjë të dhënë empirike. Janë mbajtur zgjedhjet për shembull, në Maqedoni. Dhe ato, nuk kanë ndikuar në rritjen e shkallës së infeksionit. Ne, me vota demokratike nuk kemi të drejtë me e mohue vullnetin demokratik të qytetarë...

Është bërë një propozim mbi bazë të rregullores. Cila është arsyja që kjo nuk diskutohet ? Është tagër i KQZ-së që të shpjegoj situatën se, s'i do të kryhet ky proces ? Nuk po kërkojmë vendim, por kërkesë nga ISHKP-ja që të shpjegohet gjendja rreth këtij procesi...

**Čemaili Kurtishi:** Kjo pyetje nuk është e lidhur me KQZ-në. Kjo nuk është kompetencë e jona, prandaj mendoj që ne ndoshta nuk duhet të vijmë te ky debat. Por, kjo s'është e ndaluar s'i pyetje të bëhet. Por, ne s'duhet të humbim kohë, janë institucionet tjera që vendosin...Pajtohem që të shtrohet kjo pyetje te ISHKP-ja.

**Sami Hamiti:** Së pari, ne po e thyejmë rregulloren se propozimi shkon gjithmonë pa diskutim, pa debat. Ne, po e shterrim kështu debatin ! Unë po i përmendi dy situata. E para, kur filloi pandemia, ne bëmë kërkesë për sqarime. Kërkesa, ishte e domodoshme. Pezullimi, nuk ka ndodh pse ne kemi bërë kërkesë,

por në bazë të gjendjes së krijuar. E dyta, në këtë rast, nuk kemi datë por, kjo s'varet nga ne. Institucioni që i shpallë zgjedhjet, ai vendos. Kjo, tash është vetëm për të bërë politik. Shpallja, është kompetencë e dikujt tjetër...

**Alim Rama:** Unë, e arsyetova shkresën time që e kam dërguar. Është një kërkesë e imja qe katër muaj, dhe ende nuk ka ardhur në rend dite. Kërkesa ime, është legititime...

Rreth kësaj teme të ngritur, diskutuan në vazhdim: Sami Hamiti, Alim Rama, Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj dhe Eshref Vishi.

**Artan Asllani:** Shkojmë me pikën e parë të propozuar: "Kërkesa për ISHPK-në lidhur me vlerësimin e gjendjes së pandemisë"!

Me 2 vota abstenim, 2 vota për dhe me 5 vota kundër, kjo pikë nuk hynë në agjendën e kësaj mbledhje.

Pika tjetër, "Raporti i Sekretariati për përgatitjet lidhur me vazhdimin e zgjedhjeve në Podujevë". Këtë pikë nuk e hedhim në votim, sepse e diskutojmë në mbledhjen tjetër.

Pika e tretë, propozimi i kryeshefit: "Njoftim nga Sekretariatit".

**Sami Hamiti:** Tani po votojmë, por herëve tjera le të jetë një pikë e rregullt.

**Alim Rama:** Jam për raport, por unë nuk kam pasur kohë me u përgatitë lidhur me reportin!

**Sami Hamiti:** Po, për këtë thash edhe të jetë pikë e rregullt në mbledhje.

**Arianit Elshani:** Po, po njoftohemi rrreth aktiviteteve edhe në këtë mbledhje. Nuk duhet të mbajmë standarde të dyfishta. Ta dëgjojmë kryeshefin, edhe le të jetë kjo një pikë e rregullt...

**Sami Kurteshi:** Nëse, patjetër duhet të përgatitemi për diskutimin e raportit...? A ka diçka specifike...?

**Burim Ahmetaj:** I keni me shkrim, dhe ne mendojmë se rapportet të jenë të rregullta.

**Artan Asllani:** Kush është për...? Se, po e hedhim në votim.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan propozimin e kryeshefit.

**Alim Rama:** Të bazohemi më shumë në rregullore, dhe propozoj që shumë çështje t'i marrim me konsensus. Sepse, është në të mirë...

**Artan Asllani:** Vazhdojmë me mbledhjen. Kush është për këtë rend dite...?

## **2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 35, 36 dhe 37/2020**

Lidhur me procesverbalet, z. Eshref Vishi tha se vërejtjet që i ka rreth përmbajtjes, do t'i dërgoj me shkrim për përmirësim, kurse z. Sami Kurteshi, tha se procesverbalet të jenë të sakta, por edhe të përfshihen çështjet edhe kur nuk ka mospajtime, ose ngashëm...

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalet.*

### **3. Aktivitetet e Sekretariatit**

**Burim Ahmetaj:** Nuk do të ju marrë kohë, me aktivitetet që janë zhvilluar mes dy mbledhjeve, mirëpo do ju njoftoj me 5 pikat e rëndësishme:

1. *Sekretariati, është në fazën e vlerësimit të planit të punës për vitin 2020, dhe përgatitjen e raportit për zbatimin e këtij plani.*
2. *Plotësim - ndryshimi i rregullave zgjedhore. Tani, jemi në dinamikë të draftimit të tyre...*
3. *Vlerësimi i planit strategjik: 2021-24. Po i vlerësojmë planet strategjike të kaluara, dhe besoj shpjet do të hyjmë në dinamikën e këtij plani strategjik...*
4. *Regjistrimi – inventarizimi i pasurisë së KQZ-së.*
5. *Përgatitja e listës së vendvotimeve që janë ruajtur nga prokuroria në vitet 2007-2009, dhe që kjo ka të bëjë me asgjësimin e tyre.*

Aktivitetet e tjera, janë kryesisht të zakonshme. ..

**Sami Kurteshi:** Aty ku flitet për përgatitjen e strategjisë së KQZ-së, pra të planit strategjik...! Është themeluar ndonjë grup punues, apo s'i jeni duke vepruar ?

**Burim Ahmetaj:** Është ngarkuar zëvendëskryshefi që do të hartoj një dinamikë të planit se s'i do të veprojmë...pra, ai do ta udhëheqë këtë proces.

**Eshref Vishi:** Kam gati kam të njëjtën pyetje: ne, paraprakisht e kemi të formuar një grup punues më herët, dhe mundet që ky grup të jetë aktiv, ose që së paku të aktivizohet në formimin e strategjisë 2021-24.

**Burim Ahmetaj:** Sapo ta kalojmë këtë fazë, do ta dimë qartë dinamikën, dhe do të përshtaten edhe shumë aktivitete rreth këtij procesi...Tani për tani, puna po bëhet vetëm brenda Sekretariatit, vlerësimi, përshtatja me planin paraprak...

**Arianit Elshani:** Kjo është një pikë e rëndësishme që u theksua nga folësit paraprak lidhur me këtë çështje. Kjo, është filluar me krijimin e grupit punues, kemi mbajtur dy takime ku janë përfshirë edhe kërkesat e anëtarëve që ky plan i veprimit të organizohet, hapat të përcaktohen qartë, çështjet që do t'i trajtojmë... Disa nga këto aktivitete vec janë filluar nga ish kryeshefi, dhe të tjerat që po vazhdojnë...

**Sami Kurteshi:** Unë, tashmë e kuptova, pra grupi duket që është funksional. Por, ne kur kemi diskutuar për formimin e grupit, unë nuk jam pajtuar rreth formimit të grupit. KQZ ka vendosur me vota, por unë nuk e ditkam formimin e grupit...! Aso kohe, unë e di që nuk jam pajtuar dhe ju e dini që ne si përfaqësues të VV-së, kemi kërkuar të jemi në grup të dy përfaqësuesit... Nuk ka pasur asgjë personale... Në këtë pikë, diskutuan edhe: Arianit Elshani, Alim Rama, Artan Asllani dhe Burim Ahmetaj.

Rreth grupit në fjalë, formimit të tij dhe çështjeve të tjera të aktiviteteve, nuk u pajtuan Sami Kurteshi dhe Alim Rama të cilët, dhanë shpjegimet dhe vërejtjet e tyre.

**Artan Asllani:** Vazhdojmë me pikën tjetër të mbledhjes:

#### **4. Aktivitetet e ZRPP-së:**

Njoftim për aplikimin e një iniciative për regjistrim të partisë politike

**YII Buleshkaj, drejtor i ZRPC:** Këto ditë ka pasur mjaft punë, kemi shqyrtuar 11 borde duke i krahasuar ata me listat e partive politike që kanë pozita udhëheqëse në to, e që zyra i procedon dhe i posedon! Javën e kaluar kemi pasur takim me partitë politike dhe me ta, i kemi shqyrtuar idetë që kemi për ndryshimet s'i në rregullore, e s'i në teknologji informative në komunikim dhe raportim reciprok... Kemi pranuar një aplikacion - iniciativë për një parti të re politike turke. Aplikimi, është në shqyrtim publik, dhe besojmë se sipas ligjit, do ta procedojmë së shpejti për aprovim në KQZ. Emri i partisë, është "YHTP".

I kemi verifikuar edhe emrat - nënshkruesit e kësaj iniciative, a janë në listën votuese të vendit, dhe mendojmë se kjo është korrekte. Statuti, është në rregull dhe specifikat e tjera që kërkohen...

#### **5. Raport i Këshillave të KQZ-së**

**Këshilli për Çështje Ligjore:**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Gjakovë

**Eshref Vishi:** Këshilli, ka shqyrtuar dy kërkesa për zëvendësim të anëtarëve në kuvendin komunal të Gjakovës, dhe i ka rekomanduar KQZ-së miratimin e zëvendësimeve. Vendimet janë, zëvendësimet kërkohen nga dy subjekte: AAK dhe AKR...

**Artan Asllani:** Atëherë, kush është për që Gëzim Cudina nga subjekti politik AKR të emërohet anëtarë i asamblesë komunale në Gjakovë, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm Edmond Dushi. Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim.

Kush është për që Ismet Bardhoshi nga subjekti politik AAK të emërohet anëtarë i asamblesë komunale në Gjakovë, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm z. Haxhi Sejdiu.

**Sami Kurteshi:** Është një rast, unë kam qenë kundër sepse shkelet ligji për barazi gjinore. Tejkalohet kandidatja në listën e subjektit të caktuar kandidatja femër me numër me numër më të madh votash, dhe zgjidhet kandidati i radhës mashkull me numër më të madh votash. Ky, është një abusurd ! Çështja, është në gjykatën kushtetuese ! Ne mendojmë se, këtu ka shkelje ligjore për shkak të gjinisë, pra nuk është në rregull mbi bazën ligjore...

**Artan Asllani:** Deri sa është ligji, ne jemi të thirrur të veprojmë sipas ligjit...

**Alim Rama:** Ky është interpretim. Ky nen, ka pasur për qëllim ruajtjen e kuotës gjinore, por në këtë rast nuk ruhet, bile shkelet kuota gjinore...

**Artan Asllani:** Falemnderit, po kush është për...?

Me 7 vota për dhe 2 vota kundër, miratohet ky rekomandim.

## 2. Njoftim lidhur me publikim të raporteve vjetore financiare të subjekteve politike

**Eshref Vishi:** Këtu, është pak më ndryshe, kemi pasur një rekomandim nga këshilli lidhur me publikimin e raporteve financiare të subjekteve politike... Ne, e kemi kthyer këtë rekomandim në administratë për këshillim ligjorë dhe në mbledhjen e radhës, dhe në mbledhjen e radhës të këshillit do ta kemi për shqyrtim prapë këtë pikë dhe do ta rekomandojmë në mbledhjen e ardhshme të KQZ...

**Sami Kurteshi:** Unë kam qenë kundër, kam votuar kundër. Është një zyre relativisht e pavarur e partive politike. Këshilli ka vendosur 3 me 1. Por, zyra ligjore nuk është kompetente për dhënien e interpretimit dhe vendimit se, a duhet kjo të shkoj më tej, apo jo...! Mirëpo, me vota është vendos ndryshe...

**Eshref Vishi:** Megjithatë, edhe zyra ligjore ka të drejtë....! Ne, kemi kërkuar vetëm mendim ligjor, dhe se prapë kjo do të kthehet në shqyrtim, deri sa të vij në KQZ...

Në këtë pikë, diskutuan më tej: Alim Rama, Eshref Vishi, Sami Kurteshi dhe Arianit Elshani, i cili bëri një elaborim të gjerë të kësaj pike... Në anën tjetër, anëtarët e tjerë të KQZ-së patën vërejtjet e tyre rreth formulimit, s'i dhe rreth përbajtjes së kësaj pike. Njësoj, s'i edhe rreth raportit të subjekteve politike... **Čemailj Kurtishi**, kërkoi që KQZ të mos politizohet, aq më pak mendimet dhe vlerësimet të mos janë politike. Nëse duhet, tha ai, duhet sqaruar gjithçka. Por, edhe mund të presim, e vendosim në mbledhje tjetër, e shqyrtojmë...

**Alim Rama**, tha se, kjo pikë nuk është "njoftuese", por "shqyrtuese dhe miratuese". Së paku, kështu është agjenda, tha ai... Të njëjtën çështje, e diskutoi edhe Sami Kurteshi që tha se, agjendat janë të ndryshme, kush i përgatitë, kush i shkruan ato...?

**Arianit Elshani**, tha se këtu po paragjykohen gjërat, vlerësimet dhe se disa vlerësime janë konspirative, paragjykuese...!

Eshref Vishi, kërkoi që të debatohet me qetësi dhe mbi agjendën e mbledhjes. Ai tha se, praktika e mbajtjes së dy, e ndoshta edhe tri mbledhje në ditë...dhe, mund të ndryshohet edhe agjenda...

**Arianit Elshani** tha se, partitë i kanë dorëzuar raportet dhe se ato zyrtarisht janë në KQZ, prandaj s'ka çka fshihet, dhe se ato janë ashtu siç janë dorëzuar... Pra, në momentin që vjen s'i rekomandim ne, e votojmë. Kaq...

**Sami Hamiti**, insistoi në atë që rendi i ditës është ai që ne e votuam më herët, e që ju nuk e votuat. Prandaj, kjo është... Sa u përket raporteve, ato janë dorëzuar. Nesër le të publikohen, sa më përket mua, tha ai... Tjetra: KQZ nuk i auditon, por i auditon Kuvendi i Kosovës. Këtu, tha ai veç debat po zhvillohet, por jo edhe esenca e agjendës së mbledhjes...

**Burim Ahmetaj:** Nëse ka mundësi një shpjegim: Sekretariati, i zbaton vendimet e KQZ, dhe u përshtatet vendimeve. Në kushte të mira, normale çdo këshill ishte dashur të mbahet dy – tre ditë më përpara, mirëpo, në këtë rast këshilli është mbajtur 2 – 3 orë para mbledhjes. Nuk ka pasur vendimmarrje në këtë mbledhje... Mirëpo, ndoshta secili këshill ish dashur të merr vendim se, çka duhet të shkoj në mbledhje të KQZ...

Kjo, na kursen ne, dhe ne nuk do të kishim kësi problemi.

**Artan Asllani:** Ju lutem, vazhdojmë me pikën tjetër... ! U shpjeguan të gjitha çështjet... Tani, ne i dimë procedurat se s'i shkojnë në KQZ. Tash, kemi përvojë...

### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Njoftim lidhur me reportin “Analizë e të dhënave nga Departamenti i Pensioneve në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale”:

**Alim Rama:** E keni një analizë të bërë nga Sekretariati për Listën Votuese. Ky raport, besoj ka identifikuar që kanë qenë 29 000 persona që janë ende në listën votuese... Janë bërë heqje nga ARC të rreth 5000 personave të vdekur... Sekretariati, ka bërë një punë të mirë në këtë raport...

**Burim Ahmetaj:** Detajet, mund t'i japë Besnik Buzhala që ka hartuar reportin. Ky raport, përmban gjithë personat që kanë vdekur nga viti 2000 – 2020. Janë hequr pra, **129 171** persona të cilët, në këtë periudhë janë hequr nga skema sociale. Kur vijmë te Lista Votuese, ende i kemi **23 588** persona të cilët, figurojnë në listën përfundimtare votuese. Por, duhet të punohet që këta persona duhet të hiqen. Situata më e rëndë është në Mitrovicën e veriut, ose në komunat në veri...

Sami Kurteshi, pyeti se pse ka kaq shumë persona të vdekur në listat votuese në komunat Leposaviq dhe Zubin Potok ? Pse ndodh kjo...?

Besnik Buzhala, tha se kjo me gjasë, bëhet për shkak të përfitimit të pensioneve edhe nga Kosova e, edhe nga Serbia! Pra, përfitimi me dy pensione, njëkohësisht...

Arianit Elshani, tha se në këshill është shqyrtuar çështja, pra edhe të krijohet një Data bazë prandaj, përgëzoj për punën e bërë, identifikimin e personave...

Sami Hamiti, tha se, raporti është i mirë por, sugjerimi i KOZ-it ishte që cdo zyrtar i KKZ-së të bashkëpunoj me kadastrat komunale, dhe të pastrohet lista...

### **Shqyrtimi dhe miratimi i aplikacionit për votim jashtë Kosovës**

**Alim Rama:** Kjo pikë ka ardhur në KQZ, por ishte disi e bllokuar në KOZ për rreth katër muaj. Është zhagtitur... Edhe tash po më duket materiali i mangët.... Unë, të paktën s'i kam shkresat... Kjo pikë është në planin vjetor të Sekretariatit... Nuk ka mbet shumë kohë me vazhduen procedurat e prokurimit. Por, a të shkojmë përpara me realizimin e aplikacionit, ose ta heqë krejt nga plani vjetor...

**Eshref Vishi:** Kam një pyetje: Pse nuk e ka marrë rekomandimin, cilat janë arsyet...?

**Alim Rama:** Janë ngritë çështje teknike, jo imelli – jo faksi...!

**Arianit Elshani:** Nëse shihet nga plani i punës, ka qenë e paraparë për tetor. Mirëpo, ajo që është kërkuar, është të ruhet siguria – integriteti i aplikacionit. Janë bërë keqpërdorimet e votave me postë, kemi pasur raste...! Ne, po duam që të ruhet integriteti i votës... Kemi pasur vendime të PZAP-së dhe të Gjykatës Supreme lidhur me votimin në Istog (2019), e dimë çka ka ndodhur... Duhet ta ruajmë KQZ-në, dhe jo ta dëmtojmë atë... Votimi, është bërë në emër të personave që kanë vdekur...!

Ta rrisim numrin e votuesve nga jashtë Kosovës, por kjo të ngritetë në Kuvend...? Ka tendenca për keqpërdorimin e votës nga jashtë... Ne, kemi vullnet që ta bëjmë punën tonë, por ka pasur keqpërdorime, manipulime...

**Sami Hamiti:** Kemi debatuar gjatë për këtë projekt në këshill. Herët, e kemi filluar...! Edhe reforma zgjedhore ka filluar, por s'është përfunduar! Partitet që marrin pjesë në kuvend kanë dhënë mendimet e veta, deri aty ku nuk është cenuar kushtetuta. Por, nuk ka ndodh se nuk ka pasur vullnet politik. Ka ekzistuar një iniciativë e Komisionit Evropian dhe OSBE-së, dhe është thënë që të forcohet procesi zgjedhor, e ku është përfshirë edhe votimi jashtë vendit...

Në raport me aplikacionin, nuk flitet që të ketë një proces që të votohet sa më lehtë, por që të forcohet integriteti zgjedhor!

Është, rasti i Istogut! Dihet. Ka pasur manipulime. Askush këtu nuk është që diaspora të mos votojë, por që të mos manipulohen votat e tyre... Prandaj, ky aplikacion duhet të procedohet kur të forcohet procesi zgjedhor, sepse ndryshe nuk mund të kontrollohet... Askush nuk është kundër diasporës, as ndonjë far ideje me ju ndaluar me votue... Le të ndërrohet ligji, dhe le të votojnë nëpër ambasada, dhe kaq. Për mua, ky aplikacion është shumë i hershëm...

**Ibrahim Selmanaj:** E kemi diskutuar gjatë në KOZ. E kemi një problem në listën votuese, për shembull i kemi rrëth 29 000 vetë të vdekur në listat votuese. Janë, në radhë të parë, baza ligjore, integriteti i votës, por ne kemi rekomandimet e BE dhe OSBE-së që procesi është i lënduar... Prandaj, janë këto elemente që kanë dominuar, dhe ne s'kemi mundur të ecim përpara...

**Sami Kurteshi:** Ky, është aplikacioni për votim të qytetarëve të Kosovës me të drejtë votës. Po thuhet që ka pasur manipulime, por ka pasur edhe në të kaluarën, për shembull në zgjedhjet 2010. Ama, unë i kam dënimet e zgjedhjeve të fundit: VV i ka pas 14 100 euro dënimë, LDK 74 850 euro, kurse PDK i ka pasur 100 0100 euro, AAK – PSD 89 600 euro, Lista Serbska 36 500 euro, Nisma – AKR – PD 39 500 euro... Prandaj, qysh konstatohet vjedhja, manipulimi...? Ky është procesi për lehtësim të votimit të qytetarëve që jetojnë jashtë...

Si është lënduar procesi ? Procesi, është lënduar në Kosovë, jo në diasporë !

**Eshref Vishi:** Unë, po dua trajtimin e kësaj pike nga një kënd tjetër. Këtë material, unë e kam analizue mirë. Zhvillimi i këtij web aplikacioni, ka qëllimi të mirë. Edhe objektivat, janë të pranueshëm! Por kur hartoher një dokument nga Sekretariati i cili prek dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet, duhet të citohen ato dispozita ligjore. Nuk mjafton vetëm qëllimi i mirë për ndryshim të procedurave nëse ato nuk kanë mbështetje ligjore.

Pajtohem që ka probleme në procedura, në informim, në evidentimin e statistikave të votuesve etj. Por nuk e shoh që kjo çështje mund të ndryshohet me një akt nënligjorë përderisa nuk ndryshohen procedurat e ligjit. Projekti, nuk mund të jetë mbi ligjin, mbi rregulloret...!

Në këtë pikë, diskutuan më tej edhe Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Kurteshi. Arianit Elshani, ka theksuar në fund se, kërkesa e KOZ-i është që të shihet integriteti i aplikacionit, dimensioni ligjorë...

**Arianit Elshani:** E hedh në votim se, kush është për miratimin e këtij aplikacioni ?

Me 2 vota pro, dhe 8 vota abstenim nuk kalon miratimi i aplikacionit për votim jashtë Kosove.

#### **4.Të ndryshme**